



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Nr. i Dokumentit: 22.3.1-2016-08

**RAPORTI I AUDITIMIT
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË KOMUNËS SË
GJAKOVËS
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016**

Prishtinë, qershor 2017

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikën e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërdrejt llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Gjakovës, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm *Qerkin Morina*, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga *Kapllan Muhaxheri* (udhëheqës ekipi), *Agim Sogojeva* dhe *Alban Shatri*, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Astrit Bllaca.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
2 Qeverisja.....	10
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	16
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	31
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	32
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	35
Shtojca IV: Letërkonfirmimi	40

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetor të Komunës së Gjakovës, për vitin 2016 i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit¹, të datës 19.10.2016

Auditimi ynë është fokusuar në:



(Më gjerësisht, shih Shtojcën 1)

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komunës.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare vjetore prezantojnë *një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksimi i çështjes

Si theksim i çështjes dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se projekti “Ndërtimi i 29 shtëpive për komunitete” të ndërtuara në pronën komunale në vlerë prej 2,064,161€, si dhe 131 njësi banesore, garazhet, podrumet, dhe 59 lokale afariste të evidentuara në kadastër nuk janë regjistruar në regjistrin e pasurisë në SIMFK.

Më gjerësisht, shih Pjesën 1.1 të këtij Raporti.

¹ Termi “Plani i Jashtëm i Auditimit” është zëvendësim i termit “Memorandumi i Planifikimi të Auditimit”

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Dëshirojmë të falënderojmë Kryetaren e Komunës dhe stafin e saj për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore

Theksimi i çështjes së opinionit, pasqyron dobësi në kontrollet e menaxhimit të pasurive, dhe për pasojë, shumë pasuri nuk ishin regjistruar në SIMFK. Gjithashtu, janë identifikuar edhe keqklasifikime në regjistrimin e shpenzimeve.



Kryetarja duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet e Theksimit të Çështjes. Të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i evituar gabimet në klasifikimin e shpenzimeve kapitale dhe për të bërë regjistrimin e plotë të pasurive (shih kap.1.1).

Pasqyrat fillestare përmbanin gabime, dhe ne i kemi sugjeruar komunës që të bëjë korrigjimet e duhura para se ato t' dorëzohen MF-së. Komuna në versionin final ka bërë të gjitha korrigjimet e mundshme. Megjithatë disa gabime kanë mbetur, por që nuk kanë ndikime materiale për dhënien e opinionit.



Kryetarja duhet të sigurojë që procesi i përgatitjes së PFV-ve plotësisht adreson dobësitë e identifikuara në PFV. Deklarata e bërë nga ZKA dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur draft PFV-të dorëzohen në MF duhet të nënshkruhen vetëm pas një shqyrtimi gjithëpërfshirës nga ana e menaxhmentit në lidhje me përmbajtjen dhe saktësinë e PFV. (shih kap. 1.2).

Ne kemi vërejtur se menaxhmenti kishte bërë plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, mirëpo veprimet e parashikuara me këtë plan nuk ishin zbatuar dhe disa nga rekomandimet janë përsëritur edhe këtë vit.



Kryetarja duhet të siguroj zbatimin e planeve të veprimit sipas sektorëve dhe të reagoj në gjetjet dhe rekomandimet e dhëna nga auditimi dhe në baza mujore t'i monitoroj ato. Një proces i sforcuar i llogaridhënies në planin e zbatimit të rekomandimeve duhet të vendoset (shih çështjen 3).

Ne kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësorit të vetëvlerësimit dhe kemi vërejtur se pyetësori i vetëvlerësimit i plotësuar nga stafi komunal, nuk ka adresuar çështjen e rreziqeve, të cilat mund të kanosin arritjen e objektivave dhe reagimet në rast të ndodhjes së tyre.



Kryetarja duhet të siguroj se do hartohet një listë me rreziqe për komunën në mënyrë që të përcaktoj dhe ndërmerr veprimet e nevojshme nëse ato ndodhin, si dhe t'i monitoroj në mënyrë sistematike (shih çështjen 4).

Edhe pse në disa fusha kontrollet e brendshme janë efektive, ekzistojnë dobësi evidente në disa sisteme të rëndësishme financiare, duke përfshirë prokurimin, menaxhimin e subvencioneve



Kryetarja duhet ta aplikojë një vlerësim të detajuar të prokurimit dhe fushave tjera brengosëse të theksuara në këtë Raport për t'i identifikuar arsyet për paraqitjen e dobësive si dhe veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato (shih çështjet 7 deri 19).

Komuna nuk ka arritur të vendosë kontrolle adekuate në menaxhimin e pasurive në përputhje me Rregullën Financiare 02/2013.



Kryetarja duhet të sigurojë se stafi i ngarkuar me përgjegjësi në menaxhimin e pasurisë (përfshirë regjistrimin, vlerësimin dhe inventarizimin) do të zbatojnë të gjitha kërkesat e rregulloreve mbi pasuritë (shih çështjen 20).

Përgjigja e Kryetares së Komunës

Kryetarja e Komunës ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna. Më tutje Kryetarja e Komunës është zotuar që:

- ta shqyrtoj Raportin e auditimit në Asamblenë Komunale; dhe
- deri në fund të muajit janar 2018, ta diskutoj në Asamblenë Komunale progresin lidhur me zbatimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PFV 2017 të jenë dorëzuar në Ministrinë e Financave

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne, gjithashtu, e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.1 Opinioni i auditimit

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të Komunës së Gjakovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion

Kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare'. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave vjetore financiare të Organizatave Buxhetore në Kosovë, ZKA është i pavarur nga Komuna dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se Regjistri i Pasurive Fikse nuk konfirmon gjendjen e plotë të pasurive. Pasuritë e përfituara në vlerë prej 2,064,161€ nga projekti për "Ndërtimin e 29 shtëpive për komunitete" me bashkëfinancim me Caritasin Zvicëran, ishin prezantuar në PFV si pagesë nga palët e treta, por këto objekte të banimit nuk janë regjistruar si pasuri në SIMFK. Këto shtëpi ishin ndërtuar në pronën komunale për raste sociale. Komisioni i formuar për verifikimin dhe vlerësimin e pronave ka verifikuar, matur dhe regjistruar 131 njësi banesore, garazhet shtesë, podrumet dhe 59 lokale afariste me sipërfaqe të ndryshme, të cilat janë të evidentuar në kadastër, por nuk ishin regjistruar në SIMFK.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të

Menaxhmenti i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetarja e Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga komuna, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e komunës, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të komunës.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportojë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, (me ndryshimet dhe plotësimet);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Pasqyrat Nëntëmujore me kohë;
- Planin e Prokurimit për vitin 2016; dhe
- PVF janë përgatitur me kohë dhe nënshkruar nga ZKA dhe ZKF.

Në kontekst të kërkesave për raportim, ne nuk kemi identifikuar ndonjë parregullsi.

Në kontekst të PFV-ve, kemi identifikuar mos-pajtueshmërinë dhe ishin të nevojshme disa korrigjime financiare për të përmirësuar cilësinë e tyre. Korrigjimet e sugjeruara nga ana jonë, janë kryer në tërësi.

1.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit

Për çështjet e sipër përmendura jepen rekomandimet:

Rekomandimi 1 Kryetarja duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet e Theksimit të Çështjes së Opinionit. Të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i hequr gabimet në klasifikimin e shpenzimeve jo-kapitale dhe për të bërë vlerësimin e saktë të pasurive kapitale. Po ashtu, të siguroj regjistër të plotë dhe të saktë të pasurive komunale.

Rekomandimi 2 Kryetarja duhet të sigurojë që procesi i përgatitjes së PFV-ve plotësisht adreson dobësitë e identifikuar në PFV. Deklarata e bërë nga ZKA dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur draft PFV-të dorëzohen në MF duhet të nënshkruhen vetëm pas një shqyrtimi gjithëpërfshirës nga ana e menaxhmentit në lidhje me përmbajtjen dhe saktësinë e tyre.

2 Qeverisja

Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për Komunën e Gjakovës që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha organizatat buxhetore siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një OB të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse. Prandaj, kemi aplikuar një qasje konsistente në të gjitha auditimet për të përcaktuar cilësinë e listave kontrolluese të plotësuara për vet-vlerësim dhe për ta vlerësuar saktësinë e gjendjes së paraqitur mbi qeverisjen në Kosovë.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- Fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- Fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ne kemi vlerësuar disa aktivitete që mund t'i kontribuojnë një qeverisje të mirë, si dhe mundësitë ekzistuese për përmirësim të mëtejshëm si në vijim:

Zbatimi i dobët i rekomandimeve - Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit, pasi kjo tregon se menaxhmenti nuk është duke zhvilluar mjaftueshëm proceset ekzistuese dhe kontrollet. Vetëm katër (4) nga 18 rekomandimet e dhëna ishin zbatuar.

Komuna ka bërë një progres në menaxhimin e organizatës, kryesisht në reduktimin e shpenzimeve operative, në shlyerjen e borxheve të prapambetura, si dhe veprime të konsiderueshme janë ndërmarrë në ndërtimin e marrëdhënieve kontraktuale me donatorë të ndryshëm.

Për shumicën e aktiviteteve komunale ka një komunikim dhe raportim të mirë mes bartësve të njësive dhe kryetares, të përcjellura me procesverbale, por mungon monitorimi strategjik, si dhe nuk ka një raportim formal dhe sistematik (monitorim) që i ndërlidh objektivat e komunës me rezultatet.

Komuna nuk ka prezantuar një regjistër të rreziqeve, kërkesë kjo e procedurës numër katër të dokumentit të Thesarit “Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli”.

Pyetëtori i vetëvlerësimit - Komuna ka marrë në konsideratë kërkesat ligjore të parapara me rregullat e MFK-së dhe ka përfunduar me kohë vetëvlerësimin që është kryer nga Kryetarja e Komunës dhe Drejtori i Administratës, por ka nevojë të përfshijë vlerësim më kritik ndaj arritjes së rezultateve.

Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë: Regjistrimi i pasurive komunale dhe i menaxhimit të pronave komunale.

Kryetarja ka themeluar komision të veçantë për evidentimin e të gjitha pronave komunale për të identifikuar kontestet me prona, shfrytëzimin e tyre nga persona të ndryshëm pa ndonjë bazë ligjore, si dhe shfrytëzimin e lokaleve pa kryer pagesat ndaj komunës. Deri më tani është bërë një progres i dukshëm në këtë drejtim. Pas evidentimit të pronave komunale, Projekti DEMOS ka ndihmuar komunën me disa gjeodet shtesë për të bërë matjen e sipërfaqeve të dyqaneve banesave dhe për t'i evidentuar në kadastër. Sipas verifikimit, shumica nga lokalet afariste nuk kanë kontrata valide për shfrytëzimin e tyre. Pastaj, Kuvendi kishte marrë vendim për fillimin e dhënies në shfrytëzim, duke zbatuar procedurat ligjore. Po ashtu, ishte marrë vendim për faljen e borxheve të këtyre shfrytëzuesve deri në vitin 2014.

Janë verifikuar, matur dhe regjistruar 131 njësi banesore, garazhet shtesë dhe podrumet. Komisioni për verifikimin e pronave komunale është duke përgatitur raportin final edhe për 44 parcela komunale dhënë në shfrytëzim nga Kuvendi i mëparshëm i vitit 2009.

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2015, ka rezultuar me 18 rekomandime. Komuna kishte zbatuar kërkesën për të përgatitur një Plan Veprimi brenda 30 ditëve pas pranimit të raportit të auditimit për PFV për vitin 2015 të ZKA-së, ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen të gjitha rekomandimet. Deri në përfundimin e periudhës së auditimit 2016, katër (4) rekomandime ishin implementuar, gjashtë (6) ishin në proces dhe tetë (8) nuk ishin adresuar ende. Raporti i auditimit për PFV e vitit 2015, ishte diskutuar edhe në Kuvendin Komunal gjatë muajit Korrik 2016.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shih Shtojcën III.

Çështja 3 – Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

E gjetura Komuna kishte adresuar vetëm një numër të vogël rekomandimesh. Kjo për arsyen se nuk ishte zbatuar ndonjë proces rishikimi se veprimet e parapara me planin e veprimit po zbatohen brenda afateve kohore dhe nga personat e ngarkuar për zbatimin e këtij plani. Pra, nuk vërehet ndonjë proces monitorimi dhe konfirmimi që do të identifikonte pengesat për veprim në adresimin e plotë të tyre. Një qasje e tillë është e nevojshme për të menaxhuar përmirësimet e vazhdueshme në komunë.

Rreziku Disa rekomandime po përsëriten nga viti në vit dhe kjo tregon për vazhdimin e dobësive të njëjta të kontrolleve të brendshme në sistemet kryesore financiare, që kanë rezultuar në veçanti me:

- Regjistër jo i plotë pasurive; dhe
- Keq klasifikim të shpenzimeve.

Rekomandimi 3 Kryetarja duhet të siguroj se do të shqyrtohen arsyet për mos zbatimin e rekomandimeve, si dhe do të zbatohen masa kontrolli dhe përgjegjësie ndaj stafit të ngarkuar për zbatimin e rekomandimeve. Komuna duhet të hartoj plane veprimi të cilat do të jenë të zbatueshme sipas afateve të përcaktuara, me fokus kryesor zbatimin e rekomandimeve me prioritet të lartë. Një proces i llogaridhënies duhet të vendoset.

2.2 Pyetësori i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vet-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vet-vlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar nga një pyetje kyçe në secilën komponentë të listës kontrolluese. Më poshtë, ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për komunën. Shqyrtimet tona nuk kanë për qëllim të ofrojnë komente për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vet-vlerësimit, por pasqyrojnë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për të mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 4 – Pyetëtori i vet-vlerësimit – Prioritet i lartë

E gjetura Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetëtorit të vetvlerësimit në lidhje me pesë komponentë. Kemi vërejtur se pyetëtori i vetvlerësimit i plotësuar, ka konfirmuar se komuna ende nuk ka identifikuar listën e rreziqeve të cilat mund të kanosin arritjen e objektivave dhe reagimet në rast të ndodhjes së tyre.

Komuna nuk ishte vetëkritike dhe mjaft objektive në plotësimin e pyetëtorit të vetvlerësimit. Në lidhje me planifikimin dhe zbatimin e prokurimit, janë identifikuar shumë dobësi, ndërsa përgjigja në vetvlerësim lidhur me procesin e prokurimit ishte vlerësuar me notë të lartë. Më tej, Komuna ende nuk ka arritur që të identifikoj dhe të kompletoj listën e pasurisë së paluajtshme të komunës derisa po ashtu përgjigja në vetvlerësim ishte me notë të lartë (më gjerësisht, shih nënkapitullin 3.3.5).

Rreziku Vlerësimi i proceseve, duke mos përshkruar edhe dobësitë shoqëruese, krijon një pasqyrim të pasaktë të cilësisë në menaxhimin e përgjithshëm të financave dhe efektivitetet e kontrollit, dhe rrit rrezikun që menaxhmenti të mos pranoj lëshimet dhe mangësitë ekzistuese, ndërkohë që situata faktike është ndryshe. Vlerësimet jo objektive të proceseve shpijnë edhe në vendimmarrje të gabuara.

Rekomandimi 4 Kryetarja duhet të siguroj se vetvlerësimi i proceseve bëhet me një shkallë të lartë objektiviteti dhe se vlefshmërinë e pohimeve të vetvlerësimit, përveç konfirmimeve të menaxhmentit, e bën edhe auditimi i brendshëm.

2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit komuna operon dhe sfidat me të cilat përballlet.

2.3.1 Përcaktimi i objektivave strategjike

Komuna ka hartuar një sërë dokumentesh strategjike si; Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2016-2018 për arritjen e objektivave e cila ishte mjaft gjithëpërfshirëse dhe ishte e elaboruar mirë. E njëjta ishte përcjellë me objektiva të qarta orientuese si dhe kishte të elaboruara edhe kostot për implementimin e saj. Ndërlidhja e saj me kornizën afatmesme të shpenzimeve ishte mjaft e mirë, po ashtu, edhe planet vjetore ishin të bazuara në elementet e saja. Pastaj, ekziston edhe strategjia e Zhvillimit të sektorit të bujqësisë dhe pylltarisë dhe strategjia zhvillimore 2014 – 2020 të Republikës së Kosovës, si dhe e harmonizuar sipas standardeve dhe praktikave të BE-së, normat ekologjike dhe konkurruese me vendet e rajonit dhe e mbështetur nga fondet zhvillimore qeveritare, lokale dhe ndërkombëtare; strategjia në fushën e kulturës dhe asaj sportive në funksion të promovimit dhe zhvillimit të turizmit të Gjakovës, Plani i Mirëmbajtjes së Hapësirave të Hapura Publike, etj.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara. Komuna ka raporte tre mujore dhe vjetore financiare që aprovohen në Kuvendin e Komunës dhe raport mbi progresin e investimet kapitale (3 mujor dhe vjetor) si kërkesë ligjore.

Çështja 5 - Dobësi në kontrollet menaxheriale - Prioriteti i lartë

- E gjetura** Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të komunës ka nxjerrë në pah një raportim jo efektiv financiar mbi shpenzimet dhe të hyrat tek menaxhmenti i lartë si dhe analiza të pakompletuara. Kjo ka ndodhur për shkak se formati i raporteve menaxheriale nuk ofron shpjegime rreth variancave në buxhet dhe se parashikimet buxhetore nuk janë azhurnuar në baza mujore. Si të tilla aranzhimet e përgjithshme të qeverisjes, kërkojnë përmirësim. Rrjedhimisht, draft pasqyrat financiare vjetore kanë rezultuar me pasaktësi dhe gabime. Ne kemi identifikuar se kontrollet mbi të hyrat akoma nuk janë mjaft efektive, dhe ka mangësi në kontrolle në disa fusha të shpenzimeve. Fushat kryesore ku kërkohet përmirësim janë planifikimi i projekteve kapitale, menaxhimi i borxheve dhe të arkëtueshmeve.
- Rreziku** Mos azhurnimi i raportimit financiar dhe të aktiviteteve tek menaxhmenti i lartë redukton aftësinë e menaxhmentit për të menaxhuar aktivitetet e komunës në mënyrë pro aktive si dhe ulë efektin e kontrolleve buxhetore. Kjo, gjithashtu, mund të ndikoj që të hyrat të mos arkëtohen siç pritet. Ngjashëm, mund të rezultojë në ofrimin e shërbimeve të dobëta.
- Rekomandimi 5** Kryetarja duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili mund të nxirren të gjitha informatat relevante që ndikojnë në vendimmarrjen cilësore dhe me kohë të menaxhmentit.

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

NJAB përbehet vetëm nga një zyrtar i cili ishte i emëruar gjatë muajit korrik të vitit 2016. Përbërja e kapaciteteve të NJAB, me vetëm një auditor, nuk është e mjaftueshme marrë parasysh buxhetin e komunës, dhe jo në përputhje me UA 23/2009 për themelimin dhe funksionimin e NJAB.

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) ka planifikuar vetëm dy auditime për vitin 2016. Për periudhën raportuese nuk kishte mbuluar disa nga fushat kryesore, pasi që kishte përgatitur dy (2) raporte deri në fund të vitit. Fusha rishikimit kanë qenë: (1) Zyra Prokurimit (Fushëveprimi – Janar -2015/Gusht 2016); dhe (2) Auditimi i sektorit të tatimit në pronë për periudhën Korrik - Gusht 2016.

Për më tepër, edhe këtë vit komuna nuk kishte të themeluar Komitetin e Auditimit të Brendshëm i cili do ndihmonte dhe përmirësonte funksionimin e këtij sistemi.

Çështja 6 – Mungesë stafi në NJAB – Prioriteti i lartë

E gjetura Në mungesë të stafit auditues, NJAB kishte përfunduar vetëm dy raporte. Për këtë arsye, nuk janë shqyrtuar dhe mbuluar të gjitha fushat me rrezik të lartë në veprimtarinë e komunës.

Rreziku Mos trajtimi i fushave me nivel të lartë rreziku nga auditimi i brendshëm zvogëlon sigurinë e ofruar ndaj menaxhmentit për funksionimin dhe efektivitetin e kontrolleve të aplikuara në sistemet kyçe financiare si dhe zvogëlon mundësinë që auditori i jashtëm të mbështetet në punën e NJAB. Gjithashtu, kontributi i kufizuar i komitetit të auditimit mund të rezultojë me mos adresim të rekomandimeve të auditorit të brendshëm, dhe me vazhdimin e praktikave joefektive.

Rekomandimi 6 Për të arritur përfitimet maksimale nga puna e AB, Kryetarja duhet të sigurojë se njësia e auditimit të brendshëm do të plotësohet me personel të mjaftueshëm, dhe aktivitetet e ardhshme të NJAB duhet të fokusohen drejt zhvillimit dhe zbatimit të planeve të auditimit dhe strategjinë e auditimit të bazuar në rrezik. Gjithashtu, Komiteti i Auditimit duhet të formohet në mënyrë që të sigurojë mbikëqyrjen, ngritjen dhe fuqizimin e rolit të auditimit të brendshëm.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna ka të dizajnuar një sistem të mirë të kontrolleve mbi shpenzimet dhe të hyrat. Megjithatë, si rezultat i mos zbatimit të rregulloreve dhe udhëzimeve, auditimi ynë ka nxjerrë në pah ekzistencën e disa dobësive në aspektin e pajtueshmërisë, që kanë të bëjnë me prokurimin, të hyrat dhe shpenzimet tjera. Kjo reflekton një mungesë të mbikëqyrjes së duhur nga komuna në fushat e përmendura. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi regjistrimin dhe menaxhimin e pasurive në përgjithësi janë të dobëta dhe nuk janë duke u zbatuar në mënyrë efektive. Fushat tjera ku nevojiten më shumë përmirësime, janë procesi i menaxhimit dhe i minimizimi i llogarive të arkëtueshme dhe detyrimeve dhe klasifikimi i shpenzimeve.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për komunën, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike si dhe të hyrat e arkëtuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Pranimet	2015 Pranimet	2014 Pranimet
Të hyrat vetjake	3,030,300	3,204,552	3,204,552	2,581,209	2,731,645

Të hyrat e planifikuara sipas buxhetit ishin 3,030,300€. Realizimi i të hyrave gjatë vitit ishte tejkaluar dhe Kuvendi i Komunës ka aprovuar të hyra shtesë. Në fund të vitit inkasimi ishte 3,204,552€ apo shprehur në përqindje 106%, me një rritje në vlerë prej 623,343€ në krahasim me vitin paraprak. Këtu janë përfshirë edhe gjobat e gjykatave dhe dënimet e trafikut të policisë. Ky nivel i inkasimit të hyrave është mjaft i kënaqshëm.

Të hyrat vetjake prej 1,777,413€, ishin shpenzuar kryesisht për projekte kapitale apo 70%, pjesa tjetër është shpenzuar në kategori tjera, ndërsa një pjesë e konsiderueshme e THV në vlerë 1,270,405€ ishte bartur për vitin 2017. Të hyrat e planifikuara, por të pa shpenzuara janë për investime kapitale 1,081,733€, mallra dhe shërbime 156,489€, komunalit 2,427€ subvencione dhe transfere 21,395€, si dhe paga e mëditje prej 8,640€.

Tabela 2. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Burimet e Fondeve:	19,895,982	21,044,914	19,437,159	20,104,201	19,429,426
Granti i Qeverisë - Buxheti	16,865,682	16,722,312	16,685,007	17,635,086	16,755,270
Të bartura nga viti paraprak ³ -	0	614,448	544,035	348,833	296,632
Të hyrat vetjake ⁴	3,030,300	3,204,800	2,004,529	2,002,422	2,348,116
Donacionet e brendshme dhe të jashtme	0	410,554	203,588	17,860	29,408
Huamarrja	-	50,000	-	-	-

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 1,148,932€. Kjo ishte rezultat i:

- të hyrave vetjake të bartura nga viti 2015 në shumë prej 614,448€;
- rritjes së donacioneve në shumë prej 409,748€;
- kursimet nga granti qeveritar në shumë (99,516€), në bazë të vendimit të qeverisë, si dhe një alokim prej 50,000 nga të hyrat vetjake për përfitimin e një huaje nga MF.

Në vitin 2016, komuna ka përdorur 92% të buxhetit final. Përgjithësisht, realizimi i buxhetit është në nivel jo të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 3. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	19,895,982	21,044,914	19,437,159	20,104,201	19,429,426
Pagat dhe Mëditjet	13,007,754	12,983,547	12,916,157	12,834,526	11,759,147
Mallrat dhe Shërbimet	1,695,220	1,891,474	1,733,534	1,561,945	1,404,276
Shërbimet komunale	561,899	571,194	567,520	556,077	716,3777
Subvencionet dhe Transferet	439,982	523,969	499,615	660,160	509,556
Investimet Kapitale	4,191,127	5,074,730	3,720,333	4,491,493	5,040,070

Pavarësisht rritjes së buxhetit për shpenzime kapitale gjatë vitit, realizimi lidhur me investimet kapitale është prezantuar në vetëm 73% e buxhetit ishte shpenzuar. Për më shumë, shpenzimet reale vjetore sipas programit për investime kapitale ishin vetëm 2,489,199€ apo 49% e buxhetit final,

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

³ Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁴ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

pasi që shuma prej 918,334€ ka të bëj me pagesat e borxheve të akumuluar nga vitet paraprake si dhe shuma e pagesave prej 312,800€ ishte kryer nga Thesari në emër të përmbartimit të vendimeve gjyqësore.

Buxheti për mallra dhe shërbime është rritur për 196,254€, ndërsa janë shpenzuar 92% e buxhetit final. Përderisa ekzekutimi i buxhetit ishte relativisht i mirë, obligimet e komunës në këtë kategori kanë shënuar rritje nga 171,000€ sa ishin në fund të vitit 2015, në rreth 557,225€ në fund të vitit 2016.

Buxheti final për shërbimet komunale nuk kishte ndryshime të mëdha krahasuar me buxhetin fillestar, dhe ishte shpenzuar në nivel 99%. Në anën tjetër obligimet e papaguara për këtë kategori në fund të vitit ishin 165,503€, apo 29% e buxhetit. Kjo ka ndodhur për shkak të pamundësisë së komunës për të planifikuar dhe menaxhuar mirë me buxhetin në dispozicion.

Komuna ka pranuar gjithashtu grante nga donatorët në vlerën 409,748€. Ekzekutimi i këtyre mjeteve ishte relativisht i ulët në këtë fushë ku shpenzimet ishin vetëm 50%.

Çështja 7 – Realizimi i buxhetit – Prioriteti i lartë

- E gjetura** Realizimi i buxhetit nuk ishte në nivelin e pritur dhe vlera prej 1,270,405€ e fondeve vetjake janë bartur si të pa shpenzuara. Shpenzimet e tjera kanë mundur të bëhen në fund të vitit, për obligimet e pa paguara të cilat kanë arritur në nivel domethënës (shih kapitullin 3.5).
- Rreziku** Planifikimi dhe realizimi jo i duhur i buxhetit do të rezultojë në mos arritjen e objektivave të organizatës. Kjo ka ndodhë për arsyen se gjatë vitit aktual janë financuar detyrimet e viteve të mëparshme.
- Rekomandimi 7** Kryetarja duhet të siguroj që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.

3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna në 2016 ishin 3,204,552€. Kjo rritje është ndikuar nga inkasimi i të hyrave të tatimit në pronë si kategori dominuese në strukturën e hyrave vetjake.

Komuna ende nuk ka të vendosur kontrolle të brendshme efektive që kanë të bëjnë me mbledhjen dhe raportimin e të hyrave, përfshirë agregimin e tyre në PFV.

Çështja 8 - Mangësi në raportim - Prioritet i lartë**E gjetura**

Në Drejtoritë komunale të dhënat ekzistuese në shumë raste nuk menaxhohen në mënyrë adekuate. Në këto drejtori, të dhënat kontabël, duke përfshirë saldot mujore, nuk janë të harmonizuara me zyrtarin e të hyrave në zyrën qendrore të financave, siç kërkohet sipas rregullës financiare për të hyrat Nr. 03/2010.

Zyra komunale e tatimit në pronë është e obliguar që çdo vit të bëjë verifikimin (rianketimin) në terren të 1/3-ës së pronave të regjistruara. Kjo bëhet me qëllim të përditësimit të shënimeve ekzistuese. Komuna e Gjakovës, gjatë viti 2016 ka verifikuar vetëm 3.2 % të numrit total të pronave (897 nga 27,319). Megjithatë, me qëllim të përditësimit të shënimeve ekzistuese Komuna ka kryer edhe 7,521 verifikime të pronave, të cilat nuk janë kryer sipas kërkesave ligjore (nuk janë kryer ri anketime).

Gjatë vitit 2016 ishin inkasuar të hyra nga tatimi në pronë për këtë vit dhe vitet e mëhershme 1,563,827€, kurse faturimi vetëm për këtë vit ishte 2,002,365€. Komuna nuk ka aplikuar ndonjë qasje pro aktive për mbledhjen e tatimit në pronë.

Në bazë të UA Nr. 05/2012 për tarifat e shërbimeve dhe produkteve kadastrale kontrollimi dhe regjistrimi në regjistër i të dhënave nga terreni tarifohet në shumën prej 20€ për njësi kadastrale. Në një nga pesë mostrat e testuara, kemi konstatuar se në pagesën në vlerë prej 1,251€ nuk janë tarifuar dy njësi kadastrale, rrjedhimisht të hyrat janë nënvlerësuar për 40€. Pas identifikimit të këtij gabimi nga ana jonë, zyra kadastrale komunale ka ri-faturuar klientin dhe pagesa është realizuar.

Rreziku

Mungesa e shënimeve të plota mund të sjellë në situata që gabimet eventuale të mos zbulohen me kohë. Po ashtu, mungesa e kontrolleve efektive në menaxhimin e të hyrave vetjake do të vazhdojë të rezultojë me shkallë të ulët të inkasimit të tyre. Mos verifikimi i 1/3 të pronave mund të rezultojë me mangësinë e informatave të plota të pronës së tatueshme aktuale, me ndikimin e mundshëm që të hyrat e vlerësuara për tatimin në pronë të ulen.

Rekomandimi 8

Kryetarja duhet të siguroj një proces të harmonizimeve të rregullta mujore ndërmjet drejtorive komunale dhe administratës së financave, si dhe të vendos kontrolle të qëndrueshme që sigurojnë një planifikim të mirëfilltë dhe inkasim efektiv të të hyrave vetjake të komunës. Gjithashtu, duhet të bëhet edhe procesi i verifikimit të pronave komunale, siç parashihet me ligj.

Çështja 9 - Mos shqyrtimi i lejeve ndërtimore brenda afateve ligjore - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Gjatë rishikimeve tona, kemi vërejtur se në dy nga tetë rastet e testuara, nuk është respektuar afati ligjor për shqyrtimin e lejes ndërtimore. Ligji i ndërtimit në fuqi, vendos afatin prej 45 ditëve për shqyrtimin e lejes ndërtimore të kategorisë së II-të, duke numëruar ditët që nga pranimi i kërkesës. Vonesat në shqyrtimin e lejeve ndërtimore në fjalë janë 31 deri në 39 ditë.
- Rreziku** Afatet e tej zgjatura për shqyrtimin e lejeve ndërtimore, mund të ndikojnë që qytetarët të fillojnë ndërtimet edhe pa lejet përkatëse.
- Rekomandimi 9** Kryetarja duhet të siguroj se Departamenti i urbanizmit do të shqyrtoj të gjitha kërkesat e qytetarëve lidhur me lejet ndërtimore dhe se të njëjtat do të shqyrtohen brenda afateve ligjore.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti i planifikuar për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 12,983,546€, ndërsa shpenzimet 12,916,157€ apo 99.5%. Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar nga Ministria e Administratës Publike. Kontrollat kyçe duhet të konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave si aprovimi dhe futja në listë të pagave të punonjësve, verifikimi i numrit të lejuar dhe kontrollat tjera dhe aprovimi i buxhetit për paga dhe mëditje nga asambleja komunale. Po ashtu, kemi rishikuar nëse punonjësit janë paguar sipas kontratës.

Çështja 10 - Kompensim me pagesë për punë jashtë orarit - Prioritet i lartë

- E gjetura** Bazuar në Ligjin për Pagat e Nëpunësve Civil nr. 3/L-147 pagesa për punë jashtë orarit llogaritet për çdo orë pune, duke i shtuar edhe vlerën varësisht nëse orët shtesë janë gjatë orarit të rregullt të ditëve të punës, gjatë fundjavës apo ditë feste, të llogaritur mbi pagën bazë. Në tetë mostrat e testuara, ne kemi vërejtur se llogaritja e kompensimit për punë jashtë orarit nuk ishte bërë saktë. Llogaritur në total, këto kompensime janë mbivlerësuar në vlerë prej 100€.
- Në tri mostra të testuara, kemi vërejtur se dosjet personale nuk janë të kompletuara në bazë të kërkesave të përcaktuara në rregullore. Dosjeve u mungojnë disa dokumente, si: kopja e çertifikatës që nuk është nën hetime, kopja e çertifikatës së lindjes dhe shtetësisë, kopja e regjistrimit në fondin pensional etj.

Rreziku Mos kompletimi i dosjeve nuk ofron mundësinë e posedimit të të dhënave të duhura për të justifikuar pagën/shtesat, ose për të mundësuar shqyrtimin e rezultateve nga vlerësimet e performancës.

Rekomandimi 10 Kryetarja duhet të siguroj që kompensimi i zyrtarëve për punë jashtë orarit të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi., të sigurojë se është ndërmarrë një rishikim sistematik i dosjeve të personelit, për të siguruar se i tërë dokumentacioni i nevojshëm është përfshirë brenda një periudhe të specifikuar kohore.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunalit në vitin 2016 ishte 2,462,669€. Prej tyre ishin shpenzuar 2,301,054€, apo 93%.

Çështja 11 - Kontratat për shërbime të veçanta - Prioritet i mesëm

E gjetura Në drejtoritë komunale ishin punësuar mbi 19 zyrtarë me kontratë për shërbime të veçanta. Nga pesë pagesat e testuara për zyrtarët e angazhuar me kontrata për shërbimet e veçanta, ka rezultuar se nuk i ishte ndaluar tatimi në burim, siç përcaktohet me Ligjin nr. 05-L-028.

Rreziku Komuna mund të jetë subjekt i ndëshkimeve nga autoritet tatimore si pasojë e mos ndaljes së tatimit në burim për personat e angazhuar përmes marrëveshjeve për shërbimet e veçanta.

Rekomandimi 11 Kryetarja duhet të siguroj se mbajtja e tatimeve në burim për personat e angazhuar përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta është në harmoni me legjislacionin e aplikueshëm në fuqi.

Çështja 12 - Pagesa për shërbimin e pa pranuar - Prioritet i mesëm

E gjetura Pagesa e datës 08.12.2016 në vlerë 4,380€ për shfrytëzimin e shërbimeve të ngrohjes nga ngrohitorja e qytetit ishte kryer për muajin dhjetor 2016 dhe janar 2017. Kjo pagesë ishte kryer për shërbimin që do të merrej në të ardhmen.

Rreziku Ekzekutimi i pagesës para se të kryhet shërbimi, është në kundërshtim me rregulloren 01/2013 për shpenzimin e parave publike, cila nuk parasheh mundësinë e parapagimeve për mallra dhe shërbime. Kjo rrit rrezikun që për mjetet e shpenzuara të mos merret kundërvlera ekuivalente.

Rekomandimi 12 Kryetarja të siguroj që çdo pagesë të bëhet vetëm pasi të jetë kryer shërbimi dhe të mos pranohen faturat dhe raportet pa përfunduar periudha për të cilën do të kryhet pagesa.

3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 523,969€. Prej tyre në 2016 ishin shpenzuar 499,615€ apo 95%, që krahasuar me vitin paraprak (2015), vërehet një trend në rritje prej 8%.

Çështja 13 – Monitorim i dobët dhe mungesa e raportimeve financiare – Prioritet i mesëm

E gjetura Kuvendi Komunal në vitin 2015 ka aprovuar kërkesën e Ngrohtores së qytetit për ndihmë në vlerë prej 202,500€, për revitalizmin e ngrohtores për sezonin 2015-2016. Kjo ndihmë financiare, nga Ngrohtorja e qytetit është kërkuar për zhbllokimin e llogarive bankare për shkak të obligimeve financiare, në mënyrë që të investohej në pajisje, shlyerjen e obligimeve për licencat ndaj Zyrës Regjionale për Energji si dhe pagat për të punësuarit për vitin 2014 dhe pjesërisht për vitin 2015. Në vitin 2015 i janë paguar ngrohtores 156,851€, kurse në vitin 2016 shuma prej 45,648€. Ne nuk kemi gjetur ndonjë raport që do të konfirmonte se fondet e dhëna janë shfrytëzuar sipas destinimit të përcaktuar me vendimet e komunës.

Rreziku Mungesa e raporteve konfirmuese për destinimin e shpenzimeve, nuk ofron sigurinë e duhur se fondet janë shfrytëzuar sipas projekt propozimeve dhe qëllimit të ndarjes së subvencioneve.

Rekomandimi 13 Kryetarja duhet të siguroj se Drejtoritë përkatëse mbikëqyrin dhe raportojnë në formë të detajuar, dhe pagesat përcillen me dëshmi të mjaftueshme dhe adekuate, në mënyrë që të sigurohet se subvencionet shpenzohen sipas qëllimit të dedikuar.

3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 5,074,730€. Prej tyre në 2016 ishin shpenzuar 3,720,333€, apo në shkallën prej 73% që krahasuar me vitin e kaluar, vërehet një ekzekutim më i dobët prej 7%.

Çështja 14 - Mos realizimi i projekteve dhe Pagesa e projekteve të pa planifikuara - Prioriteti i lartë

E gjetura Programi për Investime Publike përfshin disa projekte në vazhdim nga vitet e kaluara dhe 26 projekte të reja për vitin aktual. Megjithatë, projekti për – Asfaltimin e rrugës “Nëna Terezë” në Gjakovë, kontrata e nënshkruar në vlerë prej 157,698€, nuk ka filluar të ekzekutohet me arsyetimin se do të ndërtohet rrjeti i kanalizimit fekal në qendër të qytetit së bashku me Impiantin (donacion i huaj). Ndërsa, për projektet Asfaltimi i rrugëve në fshatin Novosellë, Pjetërshankusar, Doblibare, si dhe në fshatin Dobrugjë” në vlerë prej 978,600€ të nënshkruara në vitet paraprake nuk kishte filluar fare ekzekutimi i tyre.

Vonesat në zbatimin e projekteve janë gjithashtu të dukshme në disa projekte të filluara para vitit 2009, si: “Rruga Gradishtë-Smaq-Travë”, rrugët në “Lagjet e Brekocit”, rruga “Ujëz 2 - Fshej”, ndërtimi - asfaltimi i rrugës Madanaj-Rrypaj,” asfaltimi i rrugës “Kodra e Butinit” në fshatin Dol , ku punimet në këto projekte janë kryer prej 45% deri në 75% . Këto projekte edhe deri më tani nuk kanë përfunduar. Shkaqet kryesore ishin mungesa e fondeve për finalizimin e projekteve.

Rreziku

Planifikimi jo i saktë i projekteve shkakton kosto shtesë dhe krijon sfida buxhetore për komunën. Një ndër sfidat më kryesore ishte lidhja e kontratave më operatorët ende pa u siguruar fondet e nevojshme. Hyrja në obligime kontraktuese pa sigurimin e fondeve rrit rrezikun që komuna të mos arrijë t’i kryej me kohë obligimet e parapara me kontratë dhe t’u ekspozohet ndëshkimeve të mundshme. Kjo gjithashtu ndikon në kompletimin me kohë të projekteve. Realizimi i projekteve jashtë planit mund të rrezikojë realizimin e projekteve të planifikuara dhe arritjen e objektivave të përcaktuara.

Rekomandimi 14 Kryetarja duhet të siguroj se projektet duhet të realizohen konform planeve dhe buxhetit. Në rastet kur shfaqet nevoja për ridestitim të mjeteve apo ndryshim të projekteve, kjo të reflektohet në planet e rishikuara të buxhetit, ndërkaq duhet të ndiqen procedurat administrative të ri destinimit të mjeteve.

Çështja 15 - Dobësi sistematike në prokurim -Prioritet i lartë

E gjetura

Nga shqyrtimi i Raportit vjetor për kontratat e nënshkruara për vitin 2016 kemi identifikuar disa dobësi të përbashkëta, zhvillimi i procedurave të prokurimit të disa projekteve të cilat nuk ishin planifikuar. Mjetet prej 42,616€ “Ndërtimi i Kompleksit Memorial” në Rogovë dhe 6,833€ për “Ndërtimin dhe mirëmbajtjen e parqeve” nuk ishin të planifikuar sipas PIP-it.

Po ashtu, kemi vërejtur edhe projekte të cilat nuk kanë qenë të parashikuara me planin e prokurimit, si: Projekti “Ndërtimi i rrugës Petro Nini Luarasi dhe kanalizimit atmosferik të saj” në vlerë prej 225,449€; “Ndërtimi –Asfaltimi i rrugës në fshatin Zhabel në vlerë prej 507,946€, “Ndërtimi i shtigjeve për këmbësor në parkun e Qytetit” në vlerë 101,885€ si dhe; “Ndriçimi dekorativ për festat fund vitit” në vlerë prej 8,000€.

Rreziku

Planifikimi jo i saktë i projekteve, shkakton kosto shtesë dhe krijon sfida buxhetore për komunën. Realizimi i projekteve jashtë planit, mund të rrezikojë realizimin e projekteve të planifikuara dhe arritjen e objektivave të përcaktuara.

Rekomandimi 15 Kryetarja duhet të siguroj që projektet të realizohen në pajtim me planifikimet paraprake, ose në të kundërtën të bëhen ndryshime formale të planifikimit. Po ashtu, duhet të ushtrohen më shumë kontrole për të siguruar që dobësitë e identifikuar më lartë janë adresuar.

Çështja 16 - Shmangie e procedurave të hapura të prokurimit si dhe mungesa e sigurisë së ekzekutimit - Prioritet i lartë**E gjetura**

Ekziston edhe më tej, si nga vitet paraprake, dukuria e zbatimit të vazhdueshëm të llojit të procedurave me kuotim çmimesh dhe vlera minimale. Prej 128 procedurave të kryera në prokurim, në 66 procedura apo 52%, janë përdorur procedura kuotimi dhe atyre me vlerë minimale. Kjo ka shpie në ndarje të tenderëve ku për produkte dhe shërbime të natyrës së njëjtë, janë zbatuar një numër i madh i procedurave, si;

Komuna kishte zhvilluar procedurë me kuotim të çmimeve "Furnizimi i pemëtarëve me fidane në vlerë prej 9,990€", shërbim i cili ka mundur të përfshihet tek aktiviteti me procedurë të hapur te kontrata "Furnizimi me fidanë të drunjve dekorativë, si dhe tek kontrata ; "Furnizim të pemëtarëve me fidane të arrës dhe lajthisë " ku përfitues i këtyre dy të fundit ishte i njëjti OE.

Ngjashëm ka ndodhë edhe me furnizimin me material zyrtar; furnizimi me inventar; furnizim me perde. Për furnizime me këta artikuj, ishin nënshkruar nga tri kontrata me vlera minimale.

Në dy raste, nuk ishte aplikuar siguria e ekzekutimit të kontratës në shumën 10% (riparimi i brendshëm objekteve shkollore, tek pagesa në vlerë prej 12,125€ si dhe Rregullimi i nyjeve sanitare tek pagesa në vlerë prej 5,000€), siç kërkohet me nenin 63 të LPP. Komuna kishte kërkuar sigurinë vetëm deri në vlerën e zotimit të vitit aktual për kontratat.

Rreziku

Prania e dukurive të tilla gjatë planifikimit dhe përzgjedhjes së llojit të procedurave dëmtojnë transparencën, eliminojnë konkurrencën dhe vejnë në pikëpyetje cilësinë e shërbimeve/produkteve të pranuar dhe përmbushjen e projekteve.

Mungesa e sigurisë së ekzekutimit të kontratës, mund të sjellë në rrezik që punimet ose shërbimet të mos përfundohen me kohë dhe cilësi sipas kushteve të kontratës.

Rekomandimi 16 Kryetarja duhet të kërkojë një planifikim të hollësishëm dhe njësitë të vlerësojnë në mënyrë të drejtë kërkesat për prokurim, si dhe të respektohen në plotësi LPP si dhe UA, në mënyrë që rastet e mësipërme të mos përsëriten.

Çështja 17 - Dobësi jo - sistematike në prokurim - Prioritet i lartë

- E gjetura** Mos furnizim i artikujve të kontraktuar - Nga rishikimi i kontratës “Renovime të ngrohjeve qendrore “ në Çerdhen e fëmijëve “Ganimete Terbeshi” me rastin e pagesës së shumës prej 28,894€ ndaj operatorit, kemi identifikuar këto mangësi: Sipas pozicionit nr. 2 tek para masa dhe parallogaria ishte parashikuar të montohej kaldaja për nxehje qendrore me kapacitet 100KW. Nga ana e menaxherit të kontratës dhe organit mbikëqyrës ishte bërë pranimi dhe montimi i një pozicioni të tillë, si dhe ishte kryer çertifikimi i pagesës. Me rastin e vizitës në vendin e ngjarjes me ekipin edhe menaxherin e kontratës, vërtetua se ishte bërë furnizimi dhe montimi i një kaldaje me kapacitet 80 KW, pra me kapacitet më të vogël prej 20 KW.
- Rreziku** Rasti i mësipërm tregon për dështime të komisioneve pranuese dhe personave mbikëqyrës me rastin e kompletimit të lëndës për pagesë, dhe pranimin e shërbimeve kundrejt parasë së dhënë. Më tej, ndryshimet e pozicioneve të kontratës, rrisin rrezikun që komuna të furnizohet me produkte të cilat janë më çmime me të larta se sa çmimet e tregut.
- Rekomandimi 17** Kryetarja duhet të shqyrtoj arsyet pse rasti i mësipërm ka ndodhur, si dhe të forcoj masat e kontrollit që dështimet e tilla të mos përsëriten. Punimet duhet të mbikëqyren në vazhdimësi dhe pagesat të bëhen vetëm pasi të merret siguria e plotë se pozicionet e kontraktuara janë realizuar sipas para masave dhe para llogarisë.

Çështja 18 - Eliminimi i operatorëve më të lirë - Prioritet i lartë

- E gjetura** Kontrata “Rregullimi i hapësirës Publike pranë rrugës “Beqir Kastrati” ishte nënshkruar me datën 16.06.2016 . Me rastin e rishikimit të paramasës dhe para llogarisë kemi vërejtur se nuk ishte bërë përlllogaritja e drejtë, pasi që te Pjesa II, pozicioni “Rregullimi i Parkingut “nuk ishte përfshirë në llogaritjen përfundimtare të ofertës. Pozicionet I - Punët e pastrimit në vlerë prej 450€ si dhe pozicioni II – Pllakosja dhe nën pozicionet prej nr. 1 deri 6 në vlerë prej 27,095€ nuk ishin përlllogaritur në vlerën përfundimtare. Kalkulimet tona kanë treguar për gabime aritmetikore ku vlera e saktë e ofertës së Operatorit fitues duhej të ishte 105,483€. Mos përlllogaritja e vlerës së përgjithshme në vlerë prej 27,545€ ishte edhe determinuese në përzgjedhjen e operatorit fitues, pasi që ofertuesi tjetër i përgjegjshëm kishte ofertuar me çmim prej 87,946€. Shpjegimet e komisionit vlerësues ishin se këtë dukuri nuk e kishin vërejtur. Gjithashtu, për këtë projekt kishin filluar punimet dhe ishte kryer edhe pagesa e parë në vlerë prej 5,892€.
- Rreziku** Këto raste tregojnë për dobësi serioze dhe të vazhdueshme në prokurim. Mos rishikimi me seriozitet nga ana e komisionit vlerësues, dhe përlllogaritjet jo korrekte, sjellin shpenzime shtesë dhe vonesa në realizim e projekteve. Po ashtu, kjo mund të sjellë tek situata e përzgjedhjes së operatorëve me të shtrenjtë, meqë ofrohen informata çorientuese. Kjo dukuri diskriminon ofertuesit tjerë me çmime më të lira.
- Rekomandimi 18** Kryetarja duhet të siguroj se njësitë kërkuese vlerësojnë në mënyrë të drejtë kërkesat për prokurim. Zyra e prokurimit duhet të mbikëqyrë komisionet vlerësuese dhe të shtoj kujdesin me rastin e përlllogaritjes së pozicioneve, si dhe gabimet të vërehen me kohë dhe të korrigjohen.

Çështja 19 - Keq klasifikimi i shpenzimeve - Prioritet i lartë

- E gjetura** Komuna ka bërë katër (4) pagesa në vlerë 17,510€ nga buxheti i investimeve kapitale për mallra dhe shërbime. Këto pagesa ishin bërë për mirëmbajtjen e parqeve dhe furnizimin me drunjë dekorativ. Po ashtu, edhe gjatë vitit 2016, në bazë të vendimeve gjyqësore dhe dispozitave të nenit 39.2 të LMFPP, Thesari ka ekzekutuar një vlerë prej 162,907€ nga buxheti i investimeve kapitale për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Shkaku në lidhje me këtë, ka të bëjë me borxhet e mëdha të trashëguara që nga viti 2013 dhe mungesa e mjeteve financiare për të kompensuar operatorët ekonomik . Kjo ka bërë që një numër i projekteve kapitale të buxhetuara nuk janë përfunduar, e në raste tjera as që ka filluar zbatimin e procedurave të prokurimit.
- Rreziku** Përdorimi i fondeve në kundërshtim me ligjin për ndarjet buxhetore, rezulton me mbivlerësimin e njëjës kategori dhe nënvlerësimin e tjetrës dhe mos shpalosjet e duhura ndikojnë negativisht për shfrytëzuesit e informatave të PFV.
- Ekzekutimi direkt i pagesave nga Thesari mund të sjellë çrregullime buxhetore dhe rrezikon arritjen e objektivave si dhe realizimin e projekteve të planifikuara.
- Rekomandimi 19** Kryetarja duhet të siguroj vendosjen e sistemit të kontrollit në këtë fushë, që pagesat të bëhen sipas kodeve adekuate dhe të krijohet një strategji e përgjithshme për trajtimin e borxheve të mbetura, përfshirë buxhetimin e tyre me kohë.

3.2 Pasuritë

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi i pasurisë është një pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Një menaxhim i mirë i pasurive kërkon që komuna të ketë një pamje të plotësisë të pasurive, procedura të kontrollit dhe menaxhimit të tyre dhe të azhurnojë vazhdimisht ndryshimet në regjistrat e saj. Në memon tonë të planifikimit të auditimit, ishte identifikuar rreziku ku ka të bëjë me regjistrimin e pasurisë.

Vlera e tërësishme e pasurisë mbi 1,000€ ishte 47,081,468€, ndërsa ato nën 1,000€ ishin prezantuar në vlerën prej 411,949€. Të gjitha çështjet domethënëse rreth pasurisë janë trajtuar në seksionin 1.1 Opinioni për Pasqyrat Vjetore Financiare.

Çështja 20 - Dobësi në regjistrimin të pasurisë - Prioritet i lartë

E gjetura Komuna nuk kishte regjistruar pasurinë nën 1,000€ në Arsimit dhe Shëndetësi në modulën e E-pasurisë, siç është paraparë me nenin 6 të Rregullores 02/2013, për menaxhimin e pasurive financiare, pasi që sipas zyrtares së pasurisë, drejtoria e Arsimit ende përdorë një program të vjetër.

Rreziku Mos regjistrimi i plotë i pronave komunale, rritë rrezikun e nënvlerësimit të pasurive. Në mungesë të evidencave të duhura, pasuritë mund t'i ekspozohen humbjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të tyre të pa autorizuar. Dobësitë në regjistrimin e plotë të pasurisë, duke mos përfshirë të gjitha pranimet, vështirëson identifikimin e pasurive për të konfirmuar ekzistencën e tyre.

Rekomandimi 20 Kryetarja duhet të siguroj se procesi gjithë përfshirës i regjistrimit të pasurive do të vazhdoj dhe brenda një afati optimal do të nxirret një regjistër përfundimtar mbi pasuritë e komunës. Kërkesat në lidhje me regjistrimin dhe mirëmbajtjen e tyre duhet të aplikohen në tërësi, si dhe të siguroj një evidencë të saktë të inventarit, të gjitha hyrjet/daljet e pasurive të luajtshme me vlera nën 1,000€ të bëhen përmes sistemit e-pasuria në të gjitha dikasteret komunale.

3.2.2 Te arkëtueshmet

Lista e debitorëve ndaj komunës, sipas të dhënave në PFV është 7,950,662€. Pjesa më e madhe e këtyre llogarive kanë të bëjnë me tatimin në pronë, në vlerë 6,965,025€, pastaj taksa në firmë dhe qiraja. Në përgjithësi vlera e LLA është zvogëluar në krahasim me vitin e kaluar. Ky zvogëlim është shkaktuar kryesisht nga rritja e arkëtimit nga tatimi në pronë dhe falja e borxheve në bazë të ligjit të amnistsisë, si dhe vendimi i kuvendit komunal për fshirjen e borxheve nga qiraja për periudhën që qiramarrësit nuk kishin kontrata të vlefshme.

Çështja 21 - Nënvlërësim i llogarive së arkëtueshme - Prioritet i lartë

- E gjetura** Vlera e borxhit të pasqyruar në kartela financiare individuale të tatimpaguesve nuk korrespondon me vlerën e borxhit të paraqitur në raportin e ngarkesës dhe inkasimit. Këto diferenca kanë të bëjnë me dënimin e llogaritur për gjashtëmujorin e dytë dhe interesin e muajit dhjetor 2016 të cilat nuk janë përfshirë në raportin e ngarkesës dhe inkasimit. Këto diferenca ekzistojnë tek të gjithë tatimpaguesit tek të cilët vlera e borxhit në fund të vitit nuk ishte zero. Prandaj, vlera e përgjithshme për të cilën llogaritë e arkëtueshme janë nënvlërësuar, është 74,259 €.
- Rreziku** Mungesa e shënimeve të sakta sa i përket llogarive të arkëtueshme, mund të sjellë gabime eventuale, nëse këto nuk identifikohen me kohë. Rrjedhimisht kemi një pasqyrim jo të drejt të këtyre vlerave në PFV .
- Rekomandimi 21** Kryetarja duhet të vendos kontrolle më efektive, ashtu që evidentimi dhe pasqyrimi i saldove të llogarive të arkëtueshme të jetë i saktë.

3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2016 ishte 1,423,500€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2017. Komuna në vazhdimësi ka bërë disa përpjekje për të siguruar fonde shtesë nga qeveria, por që nuk kanë rezultuar me përgjigje pozitive, andaj për mbulimin e obligimeve të mëhershme janë reduktuar shpenzimet në kategori tjera dhe ndryshime të disa projekteve.

Çështja 22 - Niveli i lartë i obligimeve dhe rritja e detyrimeve kontingjente - Prioritet i lartë

E gjetura Komuna ka arritur të zvogëlojë obligimet e papaguara nga 2,490,750€, sa ishin në vitin e kaluar, në 1,423,500€ në fund të vitit 2016. Pavarësisht këtij fakti, Komuna përballet edhe me detyrime kontingjente në vlerë 578,670€. Këto obligime të papaguara dhe detyrimet kontingjente ngarkojnë drejtpërsëdrejti buxhetin e vitit 2016, siç është rasti i ekzekutimi i pagesave direkte nga thesari në bazë të vendimeve gjyqësor.

Mungon një sistem i evidentimit dhe menaxhimit të faturave të pranuar nga operatorët ekonomik - nga pranimi dhe deri të pagesa e tyre, dhe kjo shkakton vështirësi në menaxhimin e tyre. Sipas Rregullës Financiare 01-2013 MF- Shpenzimi i parave publike Organizata buxhetore duhet që çdo faturë të vlefshme për pagimin e mallrave dhe shërbimeve të pranuar ta paguaj brenda 30 ditësh kalendarike nga data e pranimit të faturës. Në pesë (5) raste të testuara, obligimet në vlerën prej 11,336€ nuk ishin paguar në afatin ligjor.

Rreziku Niveli i lartë i obligimeve të papaguara dhe rritja e obligimeve kontingjente, shton rrezikun që buxheti të jetë subjekt i ekzekutimeve direkte nga MF dhe vendimeve gjyqësore, por edhe në dëmtimin e reputacionit të komunës.

Rekomandimi 22 Kryetarja duhet të shqyrtoj në mënyrë kritike gjendjen e detyrimeve të papaguara, për të përcaktuar masat e nevojshme për adresimin e çështjeve të identifikuar, dhe pagesat të bëhen në kuadër të limiteve kohore të përcaktuara me rregullat financiare. Për trajtimin e detyrimeve kontingjente në koordinim me Përfaqësuesin Ligjor të Komunës, duhet të ndërmerret një rishikim të gjendjes së detyrimeve, për të përcaktuar prioritetin e pagesave, për të evituar rrethanat të cilat mund shkaktojnë pagesën e tyre drejtpërdrejt nga MF apo edhe sipas vendimeve gjyqësore.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Kryetarja duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinionin të kualifikuar, opinionin të kundërt dhe mohimin të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1.4 Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim Rekomandimi 1	Kryetarja duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF 2016 i adreson të gjitha çështjet e ngritura. Kjo, gjithashtu, duhet të përfshijë rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe fushat ku janë identifikuar gabime. Sa i përket palëve të treta, për vitin 2016 duhet të kompletohen saktë .			PFV-të janë korrigjuar në lidhje me pasuritë; nuk janë marrë veprime në lidhje me pagesat e palëve të treta
2.3 Pagesat sipas vendimeve gjyqësore Rekomandimi 2	Kryetarja duhet të siguroj se krijohet një strategji e përgjithshme për trajtimin e borxheve të mbetura, përfshirë Buxhetimin e tyre. Rastet ku komuna konteston rregullsinë e pagesave nga përmbauesit privat, të procedoj në instanca më të larta shqyrtimin e lëndëve.		Pagesat nga thesari janë prezentë por ne disa raste pagesat janë bere për t'iu shmangur pagesave të kostos shtesë, përmes përmbauesve.	
3. Rekomandimet e vitit paraprak Rekomandimi 3	Kryetarja duhet të sigurojë që plani i veprimit, zbatohet, rishikohet dhe i njëjti përcakton saktë afatet kohore për implementimin e rekomandimeve të dhëna nga AP, me stafin përgjegjës të emëruar për monitorim rigoroz të këtij procesi.		Ka një progres të implementimit, por për disa çështje ende ka hapësirë për përmirësim	

<p>2.5 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të MFK-së</p> <p>Rekomandimi 4</p>	<p>Kryetarja duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe në mënyrë pro aktive të bëhet adresimi i fushave me dobësi të identifikuara. Duhet të aplikohet një mekanizëm rishikues për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës për përgjigjet e konfirmuara.</p>		<p>Ka një progres, pasi që ishte plotësuar me një seriozitet, por në disa fusha ishte jo mjaft vetëkritik.</p>	
<p>2.6 Rishikimet specifike të qeverisjes</p> <p>Rekomandimi 5</p>	<p>Kryetarja duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një drejtor përkatës i cili në koordinim me udhëheqësit e njësive do të menaxhoj këtë proces dhe do të raportoj në baza të rregullta mbi rreziqet.</p>			<p>Nuk ishte përpiluar ende një listë e rreziqeve.</p>
<p>2.7 Sistemi i auditimit të brendshëm</p> <p>Rekomandimi 6 dhe Rekomandimi 7</p>	<p>Kryetarja duhet të sigurojë se sistemi i auditimit të brendshëm bëhet funksional dhe përfitimet maksimale merren nga shërbimet e sigurisë të ofruara nga AB. Më tej, të sigurohet se përbërja e kapaciteteve njerëzore si në njësinë e auditimit, ashtu edhe në Komitetin e Auditimit, është në përputhje me rregullat për funksionimin e sistemit të AB.</p>			<p>Ende nuk ishte funksional, pasi që ka staf të limituar duke u bazuar në Buxhetin e komunës, si dhe ende nuk ishte themeluar Komiteti i Auditimit.</p>
<p>3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit</p> <p>Rekomandimi 8</p>	<p>Kryetarja duhet të sigurojë që performanca buxhetore monitorohet në mënyrë sistematike dhe të ndërmerren masat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar.</p>	<p>Ka një performancë të mirë në ekzekutimin e buxhetit.</p>		

<p>3.4 Prokurimi</p> <p>Rekomandimi 9</p>	<p>Kryetarja duhet të kërkojë përgjegjësi nga personat që kanë lejuar lëshimet dhe humbjet e mësipërme financiare. Zyra e prokurimit duhet të shtoj kujdes në përcaktimin e pozicioneve, dhe gabimet e tilla të mos përsëriten. Një planifikim i hollësishëm është i nevojshëm dhe njësitë duhet të vlerësojnë në mënyrë të drejtë kërkesat për prokurim.</p>			<p>Ndarja e tenderëve edhe në këtë vit ishte mjaft i theksuar sidomos zhvillimi i procedurave të prokurimit me vlera minimale, si shkak i mos planifikimit nga njësia kërkuese.</p>
<p>Rekomandimi 10</p>	<p>Kryetarja të shqyrtoj arsyet pse kërkesat e rregulloreve të prokurimit nuk janë zbatuar me konsistencë në rastet e mësipërme, si dhe të forcoj masat e kontrollit që dështimet e tilla të mos përsëriten. Në rastin e trajnimit të stafit shëndetësor në të ardhmen, Kryetarja të shqyrtojë mundësitë e trajnimit nga vet pjesa e stafit. Punimet të mbikëqyrjen në vazhdimësi dhe pagesat të bëhen vetëm pasi merret siguri se pozicionet janë realizuar si dhe mangësitë e tjera në procesin e prokurimit të mos përsëriten.</p>		<p>Disa nga kërkesat janë implementuar, por në mostrat e testuar edhe me tej mbikëqyrja e kontratave , me rastin e pagesës për punimet e kryera ka neglizhencë.</p>	
<p>3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit</p> <p>Rekomandimi 11</p>	<p>Kryetarja duhet të sigurojë se ndërmerren masa në mbikëqyrjen e marrëveshjeve me bashkëfinancim përfshirë kërkesat të qarta të raportimit gjatë implementimit dhe monitorimit të projektit, në pajtim me kërkesat e marrëveshjeve si dhe rregullave për shpenzimin e parasë publike. Rasti me EUROPEAN duhet të monitorohet në veçanti në kontekst të konfirmimit të dëshmive financiare. Dhe, në rastin e marrëveshjeve të reja, të aplikohen kontrole të shtuara që asnjë pagesë të mos bëhet para se punët apo shërbimet të jenë kryer.</p>	<p>Janë zbatuar në mostrat e testuar</p>		

Rekomandimi 12	Kryetarja duhet të sigurojë se në rast të çdo tejkalimi të limiteve të telefonisë mobile, shpenzimet paguhen nga pagat e zyrtarëve përkatës si dhe të bëhet një rishikim i të gjitha shpenzimeve për vitin 2015 ku çdo mbi shpenzim t'i kthehet buxhetit të Kosovës, nga zyrtarët të cilët kanë shpenzuar në mënyrë të	Ka një përparim me rastin e tejkalimit janë zbatuar ndalesat		
3.5.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet) Rekomandimi 13	Kryetarja duhet të siguroj që rekrutimet e kandidatëve bëhen në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Për rastin e kujdestarive në shëndetësi, të siguroj se zyrtarët e pagesave i zbatojnë kërkesat e rregulloreve dhe nuk do të certifikojnë pagesat nëse kushtet nuk janë plotësuar.	Një implementim ishte vërejtur gjatë këtij viti.		
3.5.3 Subvencionet dhe Transferet Rekomandimi 14	Komuna duhet të ndalojë fenomenin e pagesës së shpenzimeve operative të përfituesve të ndryshëm, derisa lënda për pagesë të ketë dokumentacionin relevant. Rasti i ngrohtores të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme. Më tej, procedurat e prokurimit të mos anashkalohen në asnjë rast ku ato mund të jenë të zbatueshme.		Ka një progres, me rastin e monitorimit të shpërndarjes dhe ndarjes së subvencioneve.	
3.6 Të hyrat Rekomandimi 15	Kryetarja duhet të sigurojë se me rastin e rishikimit të buxhetit bëhet përshtatje e planifikimit të të hyrave, bazuar në trendin e inkasimit të periudhave të mëparshme dhe kompleksitetin e operacioneve ekzistuese. Gjithashtu, burime të mjaftueshme të vihen në dispozicion për verifikimin e pronave të tatimpaguesve.		Ka një performancë më të mirë në inkasimin e të hyrave të tatimit në pronë, por ende ka disa ngecje në disa fusha si mos zgjedhja e problemit të pronave, mos përfshirja e tatim paguesve të rinjë të tatimit në pronë	

<p>3.7 Pasuritë dhe detyrimet</p> <p>3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale</p> <p>Rekomandimi 16</p>	<p>Kryetarja duhet të sigurojë se procesi gjithëpërfshirës i regjistrimit të pasurive do të vazhdoj dhe brenda një afati optimal do të nxirret një regjistër përfundimtar mbi pasuritë e komunës. Zyrtari për menaxhim të pasurisë dhe zyrtarët e angazhuar në pranimin e mallrave/pasurive të komunikojnë në mënyrë efektive për të shmangur mos zbatimin e kërkesave të rregullores për menaxhimin e pasurive.</p>			<p>Ende ka vështirësi të bëjë rexhistrimin e pasurisë në regjistrin e pasurisë komunale, po ashtu sistemi e- pasuria nuk ishte funksionale në departamentin e Arsimit dhe QKMF.</p>
<p>3.7.2 Trajtimi i të arketueshmeve</p> <p>Rekomandimi 17</p>	<p>Kryetarja të sigurojë se drejtoria për zhvillim ekonomik mbikëqyrë mjaftueshëm historikun e taksave në biznes. Shpalosjet në pasqyra, vitin e ardhshëm ti nënshtrohen një kontrolli detal dhe të vihen kontrollë të dukshme në mbarëvajtjen e qiradhënieve. Çdo qiradhënie të mbështetet me bazë të fortë kontraktuale dhe realizimi i saj të mbikëqyret në vazhdimësi..</p>			<p>Me gjithë përpjekjet nga ana e menaxhmentit të komunës saldo e të arkëtushmeve në të gjitha kategoritë nuk ishte e saktë.</p>
<p>3.7.3 Trajtimi i borxheve</p> <p>Rekomandimi 18</p>	<p>Kryetarja duhet të instaloj sistem të protokollimit të çdo fature të pranuar nga komuna. Po ashtu, të siguroj se konfirmime formale për faturat e papaguara bëhen nga departamentet përgjegjëse ndaj kërkesave të ZKF-së.</p>			<p>Ne kemi hasur në fatura të pa protokolluar, në mungesë të buxhetit faturat paguhen pas afatit ligjor.</p>

Shtojca IV: Letërkonfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA GJAKOVË
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



<i>Data/nr</i>	11.04.2017
<i>Për:</i>	Zyrën Kombëtare të Auditimit
<i>Përmes:</i>	Znj. Mimoza Kusari – Lila, Kryetare e Komunës së Gjakovës
<i>Nga:</i>	Z. Teki Shala, Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, KK Gjakovë
<i>Tema:</i>	LETËR E KONFIRMIMIT

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Gjakovës, për vitin 2016 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Me respekt,